



## **INSTRUMENTI I SME-VE NË PROGRAMIN KUADËR TË HORIZON 2020 H2020-EIC-SME2018-2020**

**Instrumenti për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM)** (*angl.* Small and Medium-sized Enterprises-SME INSTRUMENT H2020-) në Programin Kuadër të BE për Kërkim Shkencor e Inovacion- Horizon 2020, synon mbështetje e SME-ve të cilat kanë ide innovative për të sjellë në treg produkte, shërbime si dhe modele të reja në fushën e biznesit.

### **Parimet dhe financimi i Instrumentit të SME-ve në H2020**

Mund të aplikojë çdo SME, kompanie e re, apo start up që ushtron veprimtarinë e saj në një vend anëtar të Bashkimit European apo vende të asociuara .

Fushat e veprimtarive të SME-ve që mund të aplikojnë janë të pakufizuara, por ato që duhet të mbajnë parasysh prioritet e Programit H2020 **për Sfidat Shoqërore- Societal Challenges e Teknologjite e reja të së Ardhmes- Future Emerging Technologies- FET**

Instrumenti i SME-ve ju ofron aplikantëve fitues mbështetje të plotë për të gjithë ciklin e inovacionit të biznesit. Ai ka 3 (tre) faza aplikimi ku përfshihen dhe shërbimet e asistencës teknike

### **FAZA E I-rë : STUDIMI I FIZIBILITETIT( *angl.* Feasibility Study)**

Në këtë fazë mund të aplikojë çdo SME për një grant 50,000 ( pesëdhjetë mijë ) Euro.

Periudha e zbatimit të projektit është 6 –muaj. Aplikimi dorëzohet elektronikisht

Aplikimi për Fazën e I-rë nuk duhet të jetë më shumë se 10 faqe, duke përjashtuar Anekset.

SME-të e interesuar mund ta paraqesin aplikimin në mënyrë individuale ose si pjesë e një konsorciumi SME-ve që u përkasin vendeve anëtare të BE-së apo atyre të asociuara.

Në këtë fazë përmes projekt-propozimit të paraqitur dhe grantit të përfituar, ju ofrohet SME-ve mundësitë që të shqyrtojnë leverdishshmërinë ( fizibilitetin) shkencor apo teknik dhe potencial tregtar të një ideje inovatore në fushën e produkteve, shërbimeve apo modeleve të reja të biznesit dhe për të hartuar më tej një Plan – Biznesi që do të zgjerojë e shtrijë këtë produkt inovativ në treg.

Aktivitetet e përfshira në projekt-propozimin e paraqitur mund të jenë:

- analizë risku;



- studime tregu;
- përfshirja e klientëve apo përdoruesve të produktit apo shërbimit të ri;
- analiza e kuadrit rregullator e regjimit të standarteve për produktin apo shërbimin e ri;
- administrimi i aspekteve të pronësisë intelektuale, si dhe,
- gjetja e partnerëve apo vlerësimi i leverdisshmërisë (fizibilitetit)

Qëllimi i SME-ve aplikuese në Fazën e I-rë është, të formulojë një projekt solid me potencial të lartë inovacioni në përputhje me strategjinë Europiane apo strategjinë globale të orientuar nga tregu.

Projekt-propozimi duhet të mbështetet mbi një Plan-Biznesi si dhe të hartojë specifikime në një mënyrë sa më të qartë se cili do të jetë rezultati i projektit.

#### *Kriteret e përzgjedhjes*

Gjatë vlerësimit të një projekti, tre janë kriteret bazë,

1. Impakti- 50 % ;
2. Ekslenca- 25 % dhe.
3. Cilësia dhe efektiviteti i zbatimit – 25 %.

Gjatë procesit të vlerësimit të projekt-propozimit të paraqitur merren parasysh këta elementët kryesor të cilët lidhen me kapacitetin operacional të aplikantit si:

- deklarata lidhur me kualifikimin akademik dhe profesional ( *angl.* „Curriculum Vitae“ –CV) ose informacioni mbi personat të cilët do të jenë përgjegjës për zbatimin e projektit;
- përshkrimi i produkteve, shërbimeve( duke përfshirë dataset apo softëare) që ofron SME-ja aplikuese apo arritjet e saj
- lista ku të jenë përfshirë deri në 5 projekte apo aktivitete të mëparshme që ka realizuar SME-ja të cilat lidhen me temën e projekt-propozimit;
- përshkrimi i ndonjë infrastrukture domethënëse apo paisje teknike që ka në zotërim SME –ja e cila ka rendësi për realizimin e projektit të propozuar;
- përshkrimi i palëve të treta që nuk janë partner të projektit por megjithatë kanë rol në të si psh përmes ofrimit të impianteve apo burimeve kompjuterike.

Për tu njohur me Programin e Punës( *angl.* *Working Programme*), Prioritetet e Objektivat që kërkon Komisioni European nga projektet e paraqitura për SME Instrument te H2020 gjatë viteve 2018-2020, mund të klikoni tek

[http://ec.europa.eu/research/participants/data/ref/h2020/wp/2018-2020/main/h2020-wp1820-sme\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/research/participants/data/ref/h2020/wp/2018-2020/main/h2020-wp1820-sme_en.pdf)



Për të aplikuar per SME – Instrument H2020 klikoni tek

<https://ec.europa.eu/research/participants/portal/desktop/en/opportunities/h2020/calls/h2020-eic-smeinst-2018-2020.html#c.topics=callIdentifier/t/H2020-EIC-SMEInst-2018-2020/1/1/1/default-group&callStatus/t/Forthcoming/1/1/0/default-group&callStatus/t/Open/1/1/0/default-group&callStatus/t/Closed/1/1/0/default-group&+identifier/des>

[http://ec.europa.eu/research/participants/data/ref/h2020/call\\_ptef/pt/2018-2020/h2020-call-pt-sme-1-2018-20\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/research/participants/data/ref/h2020/call_ptef/pt/2018-2020/h2020-call-pt-sme-1-2018-20_en.pdf) - Modeli i Formularit te Aplikimit per Fazën e I-rë të Instrumentit të SME H2020

### **FAZA E II-të ; NGA KONCEPTI TEK TREGU(*angl. From Concept to Market*)**

Në këtë fazë mund të aplikojë çdo SME për një grant 500,0000 (pesëqind mijë) EURO deri 2,000,000 (dy milionë) EURO.

Aplikanti/ja, mund të kërkojë një shumë financimi më të lartë ose më të ulët duke e justifikuar kërkesën e tij/saj.

Aplikimi dorëzohet elektronikisht

Aplikimi për Fazën e II-të nuk duhet të jetë më shumë se 30 faqe, duke përjashtuar Anekset.

Në këtë fazë mund të aplikojë çdo SME që ka kaluar Fazën e I-rë ose çdo SME mund të aplikojë drejtpërdrejt për në fazën e II-të nëse ka kaluar hapat që parashikon faza parardhëse.

Në këtë fazë, Programi H2020 financon 70 % të vlerës ndërsa 30 % të shumës duhet ta bashkë-financojë SME. Periudha e zbatimit të projektit është 12–24 muaj.

Në këtë fazë përmes grantit që i ofrohet SME-së fituese, bëhet e mundur të zhvillojë konceptin e saj të biznesit në një produkt, shërbim apo proces që është i gatshëm të dalë në treg në përputhje me strategjinë e rritjes e fuqizimit të kompanisë tij/saj.

Në këtë fazë projekt-propozimi mund të përfshijë aktivitete të tilla si:

- eksperimentimi;
- prototipin e produkteve,
- vlerësimin,
- demonstrimin si dhe testimin e produktit,
- shërbimin apo modelin në kushte reale dhe nxjerrjen e tij në treg.



Nëse aktiviteti i SME-ve aplikuese lidhet me një inovacion kryesisht teknologjik, parashikohet që te ketë një *Nivel të Gatishmërisë Teknologjike* (angl. Technology Readiness Level – TRL 6) apo edhe me të lartë (për këtë çdo aplikant duhet ti referohet pjesës G të Aneksit të Përgjithshëm (angl. General Annexes) në formularin e aplikimit.

Projekt – propozimi i paraqitur nga SME-të në Fazën e II-të, nga Koncepti tek Tregu duhet të jetë i mbështetur një Plan Strategjik Biznesi i cili mund të hartohet qoftë duke aplikuar në thirrjet e Fazës së I-rë apo të realizohet paraprakisht përmes formave të tjera.

Projekt – propozimi i paraqitur nga SME në Fazën e II-të, nga Koncepti tek Tregu duhet të specifikojë rezultatin e projektit dhe kriterin për sukses ashtu si edhe impaktin e kompanisë në termat sasiorë e cilësorë (psh. qarkullimi vjetor, punësimi, madhësia në treg, administrimi i Pronësisë Intelektuale, pagat, rikthimi i investimit, fitimi).

SME-ja duhet të tregojë vëmendje të veçantë për mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale dhe të paraqesë evidencë bindëse apo masat për të garantuar mundësinë e shfrytëzimit komercial të produktit apo shërbimit inovativ që ka krijuar shpesh herë e njohur si liria për të vepruar (angl. freedom to operate)

Për të aplikuar klikoni tek

<https://ec.europa.eu/research/participants/portal/desktop/en/opportunities/h2020/calls/h2020-eic-smeinst-2018-2020.html#;c.topics=callIdentifier/t/H2020-EIC-SMEInst-2018-2020/1/1/1/default-group&callStatus/t/Forthcoming/1/1/0/default-group&callStatus/t/Open/1/1/0/default-group&callStatus/t/Closed/1/1/0/default-group&+identifier/des>

### **FAZA E III-të – KOMERCIALIZIMI (angl. Commercialization)**

Në këtë fazë aplikanti fitues nga sektori i SME-ve merr mbështetjen shtesë nga Bashkimi Europian nëpërmjet **Platformës së Komunitetit të Këshillit Europa të Inovacionit** (angl. European Innovation Council -EIC Community Platform).

Nëpërmjet kësaj faze nuk ofrohet financim i drejtpërdrejtë për SME-në por asistencë teknike.

Kjo mbështetje për SME-në fituese ofrohet në formën e trajnimeve (**Akademia e Këshillit Europain të Inovacionit – European Innovation Council-EIC Academy**) lidhje me investitorë, partneritete dhe rrjete me klientë të tjerë të SME-ve të EIC (angl. EIC SME Clients)



Njëkohësisht SME-ve u ofrohen mundësi kontaktesh me firma më të mëdha që i ndihmojnë të kenë akses në tregje ndërkombëtare psh nëpërmjet pjesëmarrjes në Panaire Tregtare Ndërkombëtare.

Faza e III-të nuk është domosdomsrisht pasuese e Fazës së I dhe Fazës së II të Instrumentit të SME-ve të H2020.

Faza e III-të, ofron mbështetje specifike për klientët e SME-ve të Këshillit European të Inovacionit EIC – EIC SME Clients kryesisht për ti ndihmuar ata që të gjejnë tregje të reja apo klientë të rinj për produktet e tyre.

Gjatë periudhës 2018-2020 të Programit H2020, përveç SME-të të cilat kanë marrë grante nga Instrumenti i SME-ve, Faza e III-të do të jetë e hapur edhe ndaj SME-ve që kanë marrë grante nga skemat e hapura të financimit të H2020 si **FTI- Inovacioni i Gjurmimit të Shpejtë** (angl: Fast Track Innovation) and **FET –Teknologjitë e Reja të se Ardhmes-** Future Emerging Technologies).

Për aplikime në FET **Teknologjitë e Reja të se Ardhmes-** (angl. *Future Emerging Technologies*), mund të klikoni:

<https://ec.europa.eu/research/participants/portal/desktop/en/opportunities/h2020/calls/h2020-fetopen-2018-2020.html#c>

Për tu njohur me Programin e Punës (angl. *Working Programme*), Prioritetet e Objektivat që kërkon Komisioni European nga projektet e paraqitura për FET gjatë viteve 2018-2020, mund të klikoni tek:

[http://ec.europa.eu/research/participants/data/ref/h2020/wp/2018-2020/main/h2020-wp1820-fet\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/research/participants/data/ref/h2020/wp/2018-2020/main/h2020-wp1820-fet_en.pdf)

Për aplikime në FIT **Inovacioni i Gjurmimit të Shpejtë** (angl: Fast Track Innovation), mund të klikoni:

<http://ec.europa.eu/research/participants/portal/desktop/en/opportunities/h2020/topics/eic-fti-2018-2020.html>

<https://ec.europa.eu/programmes/horizon2020/en/h2020-section/fast-track-innovation-pilot>



Për tu njohur me Programin e Punës , Prioritetet e Objektivat që kërkon Komisioni European nga projektet e paraqitura për FIT gjatë viteve 2018-2020, mund të klikoni tek ( faqe 22-30):

[https://ec.europa.eu/easme/sites/easme-site/files/horizon\\_2020\\_work\\_programme\\_eic\\_pilot\\_2018-2020.pdf](https://ec.europa.eu/easme/sites/easme-site/files/horizon_2020_work_programme_eic_pilot_2018-2020.pdf)

Të gjitha shërbimet mbështetëse që ofrohen për SME-të aplikuese në Fazën e III-të mund të gjenden dhe janë të aksesueshme nëpërmjet linkut: **Aktivitetet Mbështetëse të Këshillit European të Inovacionit (angl. EIC Support Actions)**, i cili shërben si portal informacioni dhe hapësirë për krujimin e rrjeteve të bashkëpunimit. Për më tepër informacion, lutemi referojuni linkut:

<http://een.al/?lang=sq>

### **SHËRBIMET E ASISTENCËS PËR DREJTIMIN E SME– (angl. Coaching)**

Në rast se një SME është përfituese e grantit nga Instrumenti i SME-ve të H2020 dhe skemat e hapura të financimit të H2020si **FTI- Inovacioni i Gjurmimit të Shpejtë (angl: Fast Track Innovation)** and **FET –Teknologjitë e Reja të se Ardhmes- (angl: Future Emerging Technologies)** mund të përfitojë shërbime të asistencës për drejtimin e SME-së në fushën e biznesit (angl: business coaching).

Shërbimet e asistencës drejtuese për SME-të mbulojnë aspekte të zhvillimit të biznesit, zhvillimin organizativ të SME-ve, bashkëpunimin dhe financimin.

Për SME-të të cilat janë përfituese e grantit të Fazës së I-rë të Instrumenti të SME-ve të H2020 ofrohen deri 3 ditë asistencë drejtuese ndërsa për SME-të të cilat janë përfituese të grantit të Fazës së II-të të Instrumenti të SME-ve të H2020 ofrohen deri 12 ditë asistencë drejtuese(angl: Coaching Days).

SME-ve qw janë përfituese e grantit të skemat e hapura të financimit të H2020 si **FTI- Inovacioni i Gjurmimit të Shpejtë (angl: Fast Track Innovation)** and **FET –Teknologjitë e Reja të se Ardhmes- (angl: Future Emerging Technologies)** ofrohen deri 12 ditë asistencë drejtuese coaching days)



Shërbimi asistencës drejtuese (*angl.coaching servoces*) për SME ofrohet falas lehtësohet nga **Rrjeti European i Ndërmarrjeve- (*angl.Enterprise European Network- ENN*)**.

Ai ofrohet nga asistencë me eksperiencë në fushën e drejtimit të biznesit (*angl.Business Coaches*) që përzgjidhen nga Databasa e ekspertëve që menaxhohet nga Komisioni European.

Në çdo projekt fitues të SME-ve nga **Instrumenti i SME-ve , Rrjeti European i Ndërmarrjeve- (*angl. Enterprise European Network- ENN*)**, ofron një paketë shërbimesh që përfshin vlerësimin e inovacionit të SME-së, kapacitetet e menaxhimit , identifikimin e një asistenti me eksperiencë në fushën e drejtimit të biznesit apo të një pakete me këshilla teknike që është e nevojshme për të përmbyllur boshllëqet

**Rrjeti European i Ndërmarrjeve (ENN)** i ofron SME-ve akses në shërbimet e tij të inovacionit dhe ndërkombëtarizimit të biznesit

Për më shumë informacion për **Rrjeti European i Ndërmarrjeve- (*angl.Enterprise European Network- ENN*)**, klikoni <https://een.ec.europa.eu/>

Për më shumë informacion për **Rrjeti European i Ndërmarrjeve-Albania (*angl.Enterprise European Network- ENN*)**, klikoni

<http://een.al/?lang=sq>

Nëse dëshironi më shumë informacion për shërbimet ndaj SME –ve klikoni tek

<https://ec.europa.eu/research/eic/index.cfm>

<https://ec.europa.eu/programmes/horizon2020/en/h2020-section/european-innovation-council-eic-pilot>

<https://ec.europa.eu/easme/en/tags/european-innovation-council>

## **SHËRBIMET E MENTORIMIT(*angl. Mentoring*)**

Nëse një SME është përfituese e grantit nga Instrumenti i SME-ve të H2020 dhe skemat e hapura të financimit të H2020 si H2020si **FTI- Inovacioni i Gjurmimit të Shpejtë (*angl: Fast Track Innovation*)** and **FET –Teknologjitë e Reja të se Ardhmes- (*angl: Future Emerging Technologies*)**mund të përfitojë shërbime të mentorimit në fushën e biznesit.



Mentorimi nënkupton shkëmbimin e eksperiencës mes themeluesve, Drejtorëve Ekzekutivë apo drejtuesve të SME-ve apo kompanive të ndryshme më Europë dhe të atyre SME-ve që janë fituese të grantit nga Instrumenti i SME të H2020 dhe skemat e hapura të financimit të H2020 si **FTI- Inovacioni i Gjurmimit të Shpejtë** (*angl:* Fast Track Innovation) and **FET –Teknologjitë e Reja të së Ardhmes-** (*angl:* Future Emerging Technologies

Mentorimi synon zhvillimin e aftësive të lidërshipt në biznes si qëndrueshmëria, përballimi i vështirësive dhe qasja strategjike. Shërbimi i mentorimit përfshin takime individuale me një sipërmarrës me eksperiencë që do të ndajë përvojat mes tyre dhe do të ofrojnë mbështetje e këshillime për të ecur më tej. Mentorët do të jenë Drejtues Ekzekutiv (CEO) të kompanive që kanë kaluar nga faza e Start-Up.

Ata për zgjidhen nga një grup individësh sipërmarrësish që kanë qenë pjesë e financimit të Fazës së III të Instrumentit të SME-ve apo nga ish aplikantë të mëparshëm që ofrohen vullnetarisht ta kryejnë këtë detyrë.

Mentorët dhe drejtuesit e SME-ve përfituese të grantit nga Instrumenti i SME-ve të H2020 dhe skemat e hapura të financimit të H2020, të përfshira në një proces mentorimi takohen përmes **Platfomës Komunitare të Këshillit Europian të Inovacionit** (*angl.* European Innovation Council Community Platform) dhe gjatë takimeve të **Këshillit Europian të Inovacionit** (*angl.* – European Innovation Council- EIC)

Për më shumë informacion për **Rrjeti Europian i Ndërmarrjeve-** (*angl.* Enterprise European Network- ENN, klikoni <https://een.ec.europa.eu/>

Për më shumë informacion për **Rrjeti Europian i Ndërmarrjeve-Albania** (*angl.* Enterprise European Network- ENN, klikoni

<http://een.al/?lang=sq>

Nëse dëshironi më shumë informacion për shërbimet ndaj SME –ve klikoni tek

<https://ec.europa.eu/research/eic/index.cfm>

<https://ec.europa.eu/programmes/horizon2020/en/h2020-section/european-innovation-council-eic-pilot>

<https://ec.europa.eu/easme/en/tags/european-innovation-council>